



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE KONTROLLIT
TË TERRITORIT, MJEDISIT DHE PRONËS
Sektori i Mjedisit dhe Shërbimeve me Sipërmarrje

Nr. 3341 prot

Gramsh, më 08/10/2025

RELACION
PROJEKTVENDIMIN
"Për Miratimin e "Planit Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Urbane
(PVMIMU) 2025-2030"

Të nderuar Këshilltarë e Bashkëqytetarë!

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Urbane (PVMIMU) 2025-2030, është një dokument planifikimi strategjik i cili mundëson zbatimin e politikave kombëtare të mbetjeve në nivel lokal, si një dokument/udhëzues i rëndësishëm për menaxhimin e mbetjeve urbane në Bashkinë Gramsh.

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 Për Vetqeverisjen Vendore" dhe ligjin nr.10463 datë 22.09.2011, PVMIMU është instrumenti kryesor i planifikimit për përcaktimin e vizionit dhe objektivat specifike, të mundshëm nga ana ekonomike dhe mjedisore, në lidhje me drejtimit që do të ndërmarrë bashkia në fushën emenaxhimit të mbetjeve. Këto objektiva specifike duhet të reflektojnë orietimet e politikës kombëtare drejt menaxhimit të integruar të mbetjeve, të aktualizuara në gjendjen ekzistuese të bashkisë. Mbi bazën e objektivave specifike të dakordësuar në të gjitha nivelet vendimarrëse dhe me grupet e interesit, plani fillon dhe analizon skenarët e mundshëm të organizimit të shërbimit të shoqëruar me koston përkatëse dhe politikën fiskale që duhet të ndjekë bashkia në mbulimin e plotë të koston. Ai përfundon me një plan veprimi konkret të ndarë në afate kohore, brenda një 5 vjeçari, sipas përgjegjësisve përkatëse të aktorëve të përfshirë në zbatimin e planit. Plani është një dokument planifikimi, i cili merr fuqi të plotë me miratimin nga Këshilli Bashiak.

PVMIMU është më shumë i orientuar në veprime konkrete dhe të detajuara në lidhje me sistemin e grumbullimit, trajtimit, riciklimit, trajtimit final dhe impianteve respektive të trajtimit të mbetjeve.

Qëllimi i PVMIMU, bashkia Gramsh, konsiston në sfidën e re që ka bashkia për të ofruar shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në të gjithë territorin e saj, duke harmonizuar interesat e të gjithë aktorëve për një menaxhim të qëndrueshëm, duke optimizuar koston e shërbimit kundrejt buxheteve të limituara që ka bashkia, ku do të krahasohen dhe vlerësohen të gjitha opsionet e mundshme si dhe në hartimin e nevojave për investime kapitale për sektorin e menaxhimit të mbetjeve. Gjithashtu plani fokusohet edhe në përcaktimin e metodologjisë për zbatimin e sistemit të monitorimit, si dhe në ngritjen e kapaciteteve brenda bashkisë për zbatimin e planit.

Ky plan ka si qëllim të mundësojë dhe sigurojë si më poshtë:

- Përputhshmëri me Dokumentin e Politikave Strategjike dhe Planin Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve dhe objektivat e saj: duke kontribuar në zbatimin e politikave kombëtare dhe arritjen e objektivave kombëtare në fushën e mbetjeve.

- Opsionet e menaxhimit të mbetjeve: për të mundësuar grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve në përputhje me objektivat kombëtare. Plani identifikon fushat dhe teknologjitë e duhura për minimizimin dhe depozitimin (asgjësimin) final të mbetjeve.
- Instrumente institucionale, organizative dhe rregullore: mundëson paraqitje të plotë të kuadrit institucional, organizativ dhe rregullator dhe rekomandon masat për përmirësimin e elementeve përbërës të tij, duke përfshirë ato që kontrollojnë mbetjet në të gjithë sistemin e menaxhimit për të siguruar përputhshmërinë me standardet e menaxhimit të mbetjeve.
- Nevojat financiare për investime: duke përshkruar dhe argumentuar nevojat financiare dhe nevojën për investime për zbatimin e skemave të grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve.
- Burime financiare për investime: duke krijuar një klimë të favorshme për sigurimin e fondeve qeveritare për mbetjet sikurse dhe fonde nga institucione ndërkombëtare.

Procesi i hartimit të PVMIMU në Bashkinë Gramsh është mbështetur nga Projekti "Bashki të Forta" i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (Swiss Development & Cooperation) i zbatuar nga Helvetas, përmes asistencës teknike të ofruar nga EcoDes.

Bashkia Gramsh gjatë 5 vjeçarit të zbatimit të planit local për menaxhimin e mbetjeve kërkon mbi të gjitha të konsolidojë shërbimin në zonat ku aktualisht e ofron këtë shërbim, duke rritur gradualisht cilësinë e shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve dhe ta shtrijë atë në zonat ku aktualisht nuk e ofron shërbimin, kryesisht në Zonat rurale:

1. Konsolidimi i shërbimit dhe mbulimi 100% i pjesës urbane të bashkisë gjatë periudhës 2025-2030;
2. Zgjerimi i shërbimit nga 70% në 100% në zonën urbane dhe nga 36% në 70% në zonën rurale gjatë periudhës 2025-2030
3. Rritja e mbulimit të koston operacionale me 10% çdo vit, gjatë periudhës 2025-2030;
4. Rritja e shkallës së grumbullimit të tarifës në masën 100% për bizneset, 100% për banorët dhe 100% për institucionet përgjatë periudhës 2025-2030.

Sipas përbërjes dhe mënyrës së menaxhimit të mbetjeve, mbetjet bashkiake do të klasifikohen si më poshtë:

1. Mbetje urbane: (mbetje shtëpiake, ushqime, bimë, të riciklueshme, të dekompozuar, etj.);
2. Mbetje të veçanta urbane: (mbetje nga ndërtimet dhe prishjet, voluminoze, pajisje elektrike dhe mobiljesh, etj.) që prodhohen nga familjet apo njësitë tregtare ;
3. Mbetje të rrezikshme: prodhohen brenda territorit të bashkisë nga banorë të përhershëm apo të përkohshëm.

Sipas burimit të gjenerimit mbetjet urbane (bashkiake) klasifikohen në dy ryma:

- Mbetje të gjeneruara nga familjet (MF);
- Mbetjet e gjeneruara nga bizneset dhe industritë (MB), ku përbërja e mbetjeve nuk ndryshon nga karakteristikat e mbetjeve urbane.

Nderkohë, rryma të tjera të mbetjeve klasifikohen si mbetje masive, mbetje nga ndërtimet dhe prishjet (inerte), mbetje nga kopshtet që prodhohen në familje dhe që quhen mbetje të veçanta për të cilat njësisia vendore duhet ti ofrojë alternativa të përshtatshme për grumbullimin dhe transportin e tyre.

Për një organizim më të mirë të shërbimeve dhe eficiencës së sistemit që do të propozohet, zonat e mbetjeve ose zona brenda kufijve administrativë bashkisë do ndahet në nën-zona mbetjesh që kanë diferenca në lidhje me tipologjinë urbane, infrastrukturën rrugore apo llojin e konsumatorëve. Kjo do të shërbejë për të planifikuar infrastrukturën e nevojshme për skemat e mbledhjes dhe transportit, sidhe shërbime të tjera të ngjashme.

Në këtë plan 5 vjeçar, Bashkia Gramsh parashikon këto shërbime kryesore të menaxhimit të mbetjeve, të cilat konsistojnë në:

- i) Shërbimi i pastrimit, grumbullimit, transportit të mbetjeve ;
- ii) Depozitimi i mbetjeve në impiantin me trajtim energjie në Elbasan ;
- ii) Shërbimi i minimizimit të mbetjeve.

Propozimi i skenarëve për organizimin e shërbimit në Bashkinë Gramsh, do të bëhet bazuar në objektivin kryesorë të bashkisë për të ndërmarrë hapat për arritjen e standardit minimal të formimit të shërbimit. Të dy skenarët do të synojnë, në nivele të caktuara, ofrimin e një shërbimi me standarde sa më të larta, me kosto optimale dhe të përballueshme nga taksa paguesit, për të synuar mbulimin plotë të kostonë së shërbimit, bashkia propozon dy skenarë të mundshëm për ofrimin e shërbimit. Qëllimi i bashkisë është të rrisë cilësinë e shërbimit në sajë të përmirësimit të infrastrukturës dhe diversifikimin e shërbimeve që ajo ofron. Për secilin nga skenarët është bërë llogaritja e kostonë sipas modelit të dldp-së miratuar me VKM nr.319, date 31.5.2018 "Për Miratimin e Masave për Kostonë e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve".

Skenari 1

Bashkia Gramsh do të synojë mbulimin me shërbim të 100% të territorit të zonave urbane dhe 70% të zonave rurale. Transporti dhe depozitimi i mbetjeve do të kryhet me mjete teknologjike, të cilat duhet të kenë një proces mirmbajtje efektive dhe investime do të kryhen në blerjen e kontenerëve, për të siguruar një përmirësim të mbulimit në zonat rurale me 70%, të cilt përfshijnë; NJA Kukur, Lenie, Poroçan, Skenderbegas, Kushovë, Tunje, Sult. Frekuenca e propozuar e shërbimit të pastrimit kryhet gjatë 7 ditëve të javës në zonat urbane dhe 1 ditë në javë në zonat rurale. Planifikohet identifikimi dhe eliminimi i grumbullimeve ilegale në 70% të teritorrit të Bashkisë. Destinacioni final i mbetjeve do të jetë impianti i Elbasanit, një distance prej 50km, një drejtim.

Skenari 2

Bashkia Gramsh do të synojë mbulimin me shërbim të 100% të territorit të zonave urbane dhe 90% të zonave rurale. Bashkia planifikon të organizojë grumbullimin e diferencuar të mbetjeve, me sistemin me dy kosha në 3 lagje në qytetin e Gramsh. Mbetjet e riciklueshme të grumbulluara mund të dërgohen në bizneset e riciklimit, nëpërmjet një kontrate me palë të treta. Transporti dhe depozitimi i mbetjeve mix do të kryhet me mjete teknologjike, drejt impiantit të Elbasanit. Një nga qëllimet aktive është zbatimi i sa më shumë pikave të grumbullimit të diferencuar të mbetjeve dhe rrymave të tjera. Planifikohet ndërtimi, në NJA Kodovjat, i vend depozitimit për mbetjet inerte.

Skenarët e propozuar për planin e menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë Gramsh janë bazuar në përmbushjen e parimit për arritjen e standardit minimal për menaxhimin e mbetjeve, duke filluar nga prioritetet më bazike deri tek ato më maksimale. Skenari 1 është hartuar për të përmbushur prioritetin për shtrirjen e shërbimit në pjesën më të madhe të territorit urban dhe rural të bashkisë dhe dërgimin e mbetjeve në stacion transferimi, dhe Skenari 2 ka tentuar që të prezantojë tek bashkia masa të cilat potencialisht do të tentonin të arrinin standardin ligjor për menaxhimin e integruar të mbetjeve.

Bazuar në VKM nr. 319/2028 "Për llogaritjen e kostove dhe tarifave për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve", për secilin nga skenarët e propozuar janë bërë llogaritjet përkatëse (për detaje të kostove shiko draft PVMIMU)

Mbulimi i kostos përfshin një sistem tarifash dhe taksash, të cilat kanë si qëllim specifikisht të mbulojnë disa ose të gjitha kostot e ofrimit të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve nga përdoruesit e këtij shërbimi, në përputhje me principin "ndotësi paguan". Në lidhje me planifikimin e tarifave të pastrimit me qëllim për të mbuluar koston e plotë të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve, për bashkinë Gramsh është realizuar një ushtrim, duke supozuar që të gjitha familjet do të paguajnë tarifën dhe sa përqind do të mbulojnë barrën fiskale të kostos së shërbimit. Bazuar në tarifën e pastrimit që aplikon Bashkia Gramsh për tre kategoritë e familjeve (normale, me ndihmë ekonomike dhe familjet me anëtarë me aftësi të kufizuara), është bërë një vlerësim i barrës fiskale të familjeve kundrejt kostos së shërbimit sipas skenarëve (për detaje të kostove shiko draft PVMIMU)

Bazuar në tarifën aktuale të aplikuar nga Bashkia Gramsh në tre zonat e ofrimit të shërbimit familjet aktualisht mbajnë 17% të barrës fiskale (nëse ato do të paguajnë të gjithë) dhe pjesën tjetër do të duhet ta mbulojnë konsumatorët e tjerë (biznese dhe institucione) për koston e plotë të skenarit bazë. Në këtë kuadër, propozohet një rritje tarife për familjet normale për të mundësuar mbulimin e kostos O&M deri në 45% nga kjo kategori. Propozohet që bashkia të parashikojë një rritje të tarifës së pastrimit për familjet normale si në tabelën përkatëse në PVMIMU.

PVMIMU përcakton qartë procesin e monitorimit dhe vlerësimit të çdo aktiviteti në procesin e planifikimit të çdo operacioni në menaxhimin e mbetjeve. Një sistem i mirë monitorimi do të ndihmojë bashkinë në menaxhimin më të mirë të burimeve financiare, pasi nëpërmjet zbatimit të drejtë të tij do të përmirësohet procesi i planifikimit dhe në të njëjtën kohë përdorimi më i mirë i burimeve. Në këtë kuadër, Bashkia Gramsh duhet ta shtrijë modelin e monitorimit në të gjitha njësitë administrative, duke angazhuar edhe vetë administratorët e këtyre njësive apo stafin e tyre, që të jenë pjesë e procesit dhe të kryejnë raportimet ditore, javore dhe mujore tek qendra e Bashkisë. Në këtë mënyrë, bashkia, në sajë të ngritjes të sistemit të monitorimit në të gjithë territorin e saj, do të kuptojë më mirë nivelin e ofrimit të shërbimit, elementet ku ajo duhet të ndërhyjë për të përmirësuar situatën, apo edhe të rishikojë objektivat specifike për zonë, apo kategori të ndryshme të konsumatorëve. Me anë të këtij sistemi edhe sistemi i sanksioneve kryesisht për firmat private që ofrojnë shërbimin, për bizneset apo edhe për konsumatorët familjarë mund të ekzekutohen lehtësisht.

Një instrument tjetër mjaft i rëndësishëm për zbatimin e suksesshëm të planit të menaxhimit të integruar të mbetjeve të ngurta urbane do të jetë edhe strategjia e informimit, Bashkia duhet të sigurojë angazhimin e plotë të komunitetit duke i informuar ata në lidhje me skemën e menaxhimit të mbetjeve që po zbaton në territorin e bashkisë dhe me politikën fiskale që ajo po aplikon. Bashkia duhet të hartojë një strategji informimi, që në hapat e parë të hartimit të planit, duke informuar komunitetin në lidhje me iniciativën që ajo ka ndërmarrë, objektivat e përcaktuar, skenarët që kërkon të aplikojë dhe politikën fiskale që bashkia kërkon të ndjekë. Kjo strategji duhet të përcaktojë edhe etapa të tjera që duhet të përsëriten vit pas viti, ku

synimi kryesor duhet të jetë informimi i komunitetit në lidhje me proceset që zhvillojnë bashkia dhe marrja e opinionit të tyre në lidhje me performancën e shërbimit dhe sugjeri me që ata mund të kenë. Zhvillimi i pyetësorëve të ndryshëm, apo i dëgjësive publike në periudha të ndryshme gjatë zbatimit të planit, janë disa nga elementet që strategjia e informimit duhet të parashikojë, për të matur opinionin qytetar, i cili duhet të reflektohet si në përmirësimin e shërbimit ashtu edhe të strategjisë së informimit.

PVMMU përfundon me një plan veprimi konkret të ndarë në afate kohore, brenda një 5 vjeçari, sipas përgjegjësive përkatëse të aktorëve të përfshirë në zbatimin e planit. (për me shume detaje mund te shikonidraft PVMMU)

Propozimi për "Miratimin e "Planit Vendor të Menaxhimit të Mbetjeve Urbane (PVMIMU) 2025-2030"

Në mbështetje:

- Ligji Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore",
- Ligji nr. 10 463, datë 22.9. 2011 "Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve", neni 13, pika 7, amenduar me Ligjin nr. 156, datë 10.10.2013,
- Ligji nr. 9537, datë 18.5.2006 "Për manaxhimin e mbetjeve të rrezikshme",
- Ligji nr. 10 431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit",
- V.K.M nr.319 datë 31.05.2018 "Për miratimin e masave për koston e menaxhimit të integruar të mbetjeve,
- VKM nr. 428, datë 08.06.2016 "Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për hartën dixhitale vend depozitimeve të mbetjeve urbane",
- VKM nr. 687 datë 29.07.2015 "Për miratimin për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve",
- VKM nr. 575 datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte",
- VKM nr. 387 datë 06.05.2015 "Për miratimin e rregullave për kontrollin e asgjësimit të PCB-ve, ç'ndotjen apo asgjësimin e pajisjeve që përmbajnë PCB dhe/ose asgjësimin e mbetjeve të PCB-ve të përdorura,
- VKM nr. 127 datë 11.02.2015 "Për kërkesat për përdorimin në bujqësi të llumrave të ujrave të ndotura",
- VKM nr. 641, datë 01.10.2014 "Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin tranzit të mbetjeve jo të rrezikshme dhe mbetjeve inerte",
- VKM nr. 608 datë 17.09.2014 "Për masat e nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve BIO si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre",
- VKM nr. 579 datë 03.09.2014 "Për një shtesë në vendimin nr.99, datë 18.02.2005 të Këshillit të Ministrave, për miratimin e Katalogut Shqipëtar të Klasifikimit të Mbetjeve",
- VKM nr.418 datë 25.06.2014 "Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim",
- VKM nr. 371 datë 11.06.2014 "Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre,
- VKM nr. 229 datë 23.04.2014 "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit",
- VKM nr. 52, datë 05/02.2014 për disa ndryshime në Vendimin Nr.117, datë 13/02/2013 të Këshillit të Ministrave "Për kriteret që përcaktojnë kur disa tipe të metalit skrap pushojnë së qëni mbetje",
- VKM nr. 117, datë 13/02/2013 "Për kriteret në bazë të të cilave përcaktohet kur disa tipe të metalit skrap pushojnë së qëni mbetje",
- VKM nr. 957, datë 19/12/2012 "Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike",
- VKM nr. 866, datë 04/12/2012 "Për bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre",

- VKM nr. 765, datë 07/11/2012 "Për miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorura",
- VKM nr. 705, datë 10/10/2012 "Për menaxhimin e mbetjeve të automjeteve në fund të jetës".
- VKM nr. 452, datë 11/07/2012 "Për Landfill-et e mbetjeve",
- VKM nr. 177, datë 06/03/2012 "Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre",
- VKM nr. 178, datë 06/03/2012 "Për incinerimin e mbetjeve",
- VKM nr. 175, datë 19/01/2011 "Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të mbetjeve dhe të planit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve",
- VKM nr. 798, datë 29/09/2010 për miratimin e rregullores "Për administrimin e mbetjeve spitalore",
- VKM nr. 99, datë 18/02/2005 "Për miratimin e katalogut Shqipëtar të klasifikimit të mbetjeve",
- Udhëzimi nr. 1738, datë 12.03.2015 "Mbi kriteret e studimit -projektimit për rehabilitimin e vend - depozitimeve të mbetjeve të ngruta urbane si dhe ndërtimin e Landfilleve apo impjanteve të trajtimit të mbetjeve të ngruta urbane",


i propozojmë Këshillit Bashkiak si më poshtë vijon:

1. Të miratojë "Planin Vendor të Menaxhimit të Mbetjeve Urbane (PVMIMU) 2025-2030" bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Drejtoria Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, Mjedisit dhe Pronës dhe Drejtoria e Menaxhimit të Territorit, Shërbimeve Publike dhe Mërbajtjes së Objekteve Arsimore e Publike për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", (i ndryshuar).

Me konsiderat,





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
KËSHILLI BASHKIAK**

Gramsh, më 08/09/2025

PROJEKTVENDIM

Nr. __, datë __. __. 2025

**"Për Miratimin e "Planit Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Urbane
(PVMIMU) 2025-2030"**

Në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligji nr. 10 463, datë 22.9. 2011 "Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve", neni 13, pika 7, amenduar me Ligjin nr. 156, datë 10.10.2013, Ligji nr. 9537, datë 18.5.2006 "Për menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme", Ligji nr. 10 431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", V.K.M nr.319 datë 31.05.2018 "Për miratimin e masave për koston e menaxhimit të integruar të mbetjeve, VKM nr. 428, datë 08.06.2016 "Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për hartën dixhitale vend depozitimeve të mbetjeve urbane", VKM nr. 687 datë 29.07.2015 "Për miratimin për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve", VKM nr. 575 datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte", VKM nr. 387 datë 06.05.2015 "Për miratimin e rregullave për kontrollin e asgjësimit të PCB-ve, ç'ndotjen apo asgjësimin e pajisjeve që përmbajnë PCB dhe/ose asgjësimin e mbetjeve të PCB-ve të përdorura, VKM nr. 127 datë 11.02.2015 "Për kërkesat për përdorimin në bujqësi të llumrave të ujrave të ndotura", VKM nr. 641, datë 01.10.2014 "Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin tranzit të mbetjeve jo të rrezikshme dhe mbetjeve inerte ", VKM nr. 608 datë 17.09.2014 "Për masat e nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve BIO si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre", VKM nr. 579 datë 03.09.2014 "Për një shtesë në vendimin nr.99, datë 18.02.2005 të Këshillit të Ministrave, për miratimin e Katalogut Shqipëtar të Klasifikimit të Mbetjeve", VKM nr.418 datë 25.06.2014 "Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim", VKM nr. 371 datë 11.06.2014 "Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre, VKM nr. 229 datë 23.04.2014 "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit", VKM nr. 52, datë 05/02.2014 për disa ndryshime në Vendimin Nr.117, datë 13/02/2013 të Këshillit të Ministrave "Për kriteret që përcaktojnë kur disa tipe të metalit skrap pushojnë së qëni mbetje", VKM nr. 117, datë 13/02/2013 "Për kriteret në bazë të të cilave përcaktohet kur disa tipe të metalit skrap pushojnë së qëni mbetje", VKM nr. 957, datë 19/12/2012 "Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike", VKM nr. 866, datë 04/12/2012 "Për bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre", VKM nr. 765, datë 07/11/2012 "Për miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorura", VKM nr. 705, datë 10/10/2012 "Për menaxhimin e mbetjeve të automjeteve në fund të jetës". VKM nr. 452, datë 11/07/2012 "Për Landfill-et e mbetjeve", VKM nr. 177, datë 06/03/2012 "Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre", VKM nr. 178, datë 06/03/2012 "Për incinerimin e mbetjeve", VKM nr. 175, datë 19/01/2011 "Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të mbetjeve dhe të planit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve", VKM nr. 798, datë 29/09/2010 për miratimin e rregullores

"Për administrimin e mbetjeve spitalore", VKM nr. 99, datë 18/02/2005 "Për miratimin e katalogut Shqipëtar të klasifikimit të mbetjeve", Udhezimi nr. 1738, datë 12.03.2015 "Mbi kriteret e studimit -projektimit për rehabilitimin e vend - depozitimeve të mbetjeve të ngruta urbane si dhe ndërtimin e Landfilleve apo impjanteve të trajtimit të mbetjeve të ngurta urbane", me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Të miratojë "Planin Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Urbane (PVMIMU) 2025-2030" bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Drejtoria Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, Mjedisit dhe Pronës dhe Drejtoria e Menaxhimit të Territorit, Shërbimeve Publike dhe Mirmbajtjes së Objekteve Arsimore e Publike për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", (i ndryshuar).

SEKRETARI KËSHILLIT

Xhulja GJINI



KRYETARI KËSHILLIT

Enis ZANI